



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328 329

Nr. i Biznesit: 811326471

www.ngrohtorja.org

Datë: 11.05.2023

N.P." Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë në bazë të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, Neni 8 dhe 16 i shpallur në GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / PRISHTINË: VITI V / Nr. 90 / 01 DHJETOR 2010, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 07/2017 për Rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, shpallë këtë:

KONKURS

Pozita e punës: Inkasant/e për marrëdhënie në punë
Kohëzgjatja e mandatit - 6 (gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi.

Detyrat, përgjegjësitë dhe autoritetet:

- Është i ngarkuar/përgjegjës për faturat e konsumatorëve (shfrytëzuesve të ngrohjes);
- Inkason pagesat për ngrohjen, nga konsumatorët (shfrytëzuesit e ngrohjes), sipas tarifës së caktuar mujore, pas arkëtimit nga konsumatorët çdo ditë e bën dorëzimin e të hollave në arkë;
- Mban librin e një herë në muaj bënë barazimin e faturave të inkasuara me gjendjen sipas ngarkesës, me Udhëheqësin e Departamentit të Financave
- Mban përgjegjësi morale dhe penale me rastin e mos barazimit të ngarkesës dhe mos dorëzimit të hollave të inkasuara;
- Ndhmon punëtorët tjerë të Departamentit, kur është i lirë;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të Udhëheqësit të Departamentit të Financave dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Kualifikimi dhe aftësitë:

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- CV.
- Aplikacioni të cilin mund ta merrni dhe ta plotësoni me rastin e dorëzimit të dokumentacionit.
- Të posedojë shkollën e mesme.
- Vërtetim mbi përvojën në punë si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe eksperiencës,
- Përvojë së paku 1 vjeçare profesionale,
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj)

Kërkesat shtesë:

Të ketë aftësi dhe të jetë bashkëpunëtor i mirë.
Të jetë person me integritet dhe besueshmëri në punë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, përkatësisht prej datës **11.05.2023** deri më **25.05.2023 në 16.00h.**

Testimi dhe intervistat mbahen në lokalet e ndërmarrjes pas përfundimit të afatit të konkursit.

Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen me shkrim përmes E-mail adresës së shënuar në CV.

Dokumentacionet e kompletuara dorëzohen në N.P. "NGROHTORJA E QYTETIT" SH.A. - Gjakovë, rr. "Behije Dashi" p.n. – **Rezina.**

VËREJTJE: Aplikacionet e pa kompletuara sipas kritereve të konkursit do të anulohen dhe nuk do të shqyrtohen.